

VENDIM
Nr.6, datë 4.1.2008

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.824, DATË 6.12.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E INSTITUCIONEVE TË AUTORIZUARA PËR
VERIFIKIMIN, NË MËNYRË ELEKTRONIKE TË GJENDJES GJYQËSORE, SI DHE TË
FORMULARIT TË VETËDEKLARIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 7, 8 e 11 të ligjit nr.9614, datë 21.9.2006, “Për certifikatat elektronike të gjendjes gjyqësore”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.824, datë 6.12.2006 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa:

1. Në fund të pikës 1 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Institucionet e tjera, që kërkojnë të autorizohen për verifikim, në mënyrë elektronike, të gjendjes gjyqësore i paraqesin kërkesë Ministrit të Drejtësisë.”.

2. Pas pikës III shtohet pika III/1, me këtë përmbajtje:

“III/1. Institucionet e parashikuara në pikën 1 konfirmojnë gjendjen gjyqësore të personit të deklaruar në formularin e vetëdeklarimit nëpërmjet sistemit elektronik *fingerprint* dhe nuk mund të kërkojnë më paraqitjen e dëshmisë së penaltetit, të lëshuar nga zyra e gjendjes gjyqësore. Përfundim nga ky rregull bën institucioni i prokurorisë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha